



PROGRAME TË PËRBASHKËTA STUDIMI MASTER

NDËRMJET

UNIVERSITETIT MESDHETAR TË SHQIPËRISË

DHE

EMUNI UNIVERSITY SLOVENI

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë, në bashkëpunim me Universitetin EMUNI (Euromediterranean University) organizon studime pasuniversitare të nivelit të dytë Master Shkencor dhe Master Profesional në programet:

- Master i Shkencës në Marrëdhënie Ndërkombëtare 120 ECTS
- Master i Shkencës në Shkenca Politike 120 ECTS
- Master Profesional në Administrim Biznesi 90 ECTS

Themelimi i universitetit publik EMUNI University përfaqëson një nga gjashtë prioritetet e vendosura në "Deklaraten e Përbashkët të Samitit të Parisit për Mesdheun" të firmosur në Paris më 13 Korrik 2008. Ky Universitet është themeluar nga institucione të arsimit të lartë dhe të kërkimit shkencor të rajonit të Mesdheut. Ky Universitet është themeluar nga institucione të arsimit të lartë dhe të kërkimit shkencor të rajonit të Mesdheut. Disa nga këto institucione janë: Ky Universitet është themeluar nga institucione të arsimit të lartë dhe të kërkimit shkencor të rajonit të Mesdheut. Disa nga këto institucione janë : Université Montpellier I, Montpellier, FRANCE, Université Paris-Est, Paris, FRANCE, Université de la Méditerranée-Aix Marseille-II, Marseille, FRANCE, University of Westminster, London, UK, Polytechnic University of Valencia (UPV), Valencia, SPAIN, University of Trieste, Trieste, ITALY, University of Palermo, Palermo, ITALY, University of Porto, Porto, PORTUGAL, Aristotle University of Thessaloniki, Thessaloniki, GREECE, e shumë institucione të arsimit të lartë nga 43 vende të rajonit Euro-Mesdhetar.

Programet e studimit janë të akredituara nga Ministria e Arsimit të Sllovenisë, anëtare e Bashkimit Europian. Diploma e përfutur nga ky program i përbashkët studimi është e vlefshme në të gjitha vendet e BE-së si dhe nga të gjitha Universitetet anëtare të rrjetit universitar EMUNI.

Procesi mësimor për këto programe studimi do të organizohet në Tiranë dhe në Portoroz, Slloveni ku është selia qendrore e EMUNI University. Programet janë bilinguale në gjuhën shqipe dhe angleze.

Programet e studimit janë të akredituara nga Këshilli i Akreditimit të Shqipërisë dhe miratuar nga MASH.

Kandidatët duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:

- a. Kopje të noterizuar të diplomës universitare “Bachelor” apo të njëvlershme me të, shoqëruar me listën e notave;
- b. Kopje të noterizuar të diplomave apo certifikatave të kualifikimeve të ndryshme nëse kandidati disponon një të tillë;
- c. Fotokopje të noterizuar të kartës së identitetit/pasaportës;
- d. Dy fotografi;
- e. Dy rekomandime nga persona me titull akademik;
- f. Dëshmi të gjuhës/gjuhëve të huaja (fotokopje të noterizuar);
- g. Vërtetim nga qendra e punës nëse aplikanti është i punësuar

Për informacion më të detajuar, lutemi të na vizitoni në mjediset e Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë.